

Viti X, numri i nëntë

shtator 2006



FOREVER

FOREVER LIVING PRODUCTS HUNGARY / ALBANIA / BOSNIA AND HERZEGOVINA / CROATIA / KOSOVO / MONTENEGRO / SERBIA / SLOVENIA





Gjithmonë e më lart

ndërkohë që Armstrong dhe Aldrin shëtisin në hënë. Në kompaninë tonë ka shumë Michael Collins — ata që janë të gatshëm të kryejnë detyrën e tyre dhe të qëndrojnë në anije kur të tjerët “shëtisin në hënë”. Përhëndes anëtarët e familjes FOREVER, punonjësit dhe gjithë ata që kudo në botë ndihmojnë këtë skuadër të madhe ndërkombëtare... I falenderoj shumë të gjithë!

Armstrong dhe Aldrin lanë gjurmë këmbësh në hënë të cilat do të jenë aty për miliona vite — si një kujtesë e përhershme e vizitës së largët të njeriut. Të njëjtën gjë mund të themi edhe rreth marrdhënieve tona reciproke me njerëzit. Shpeshherë bëhet fjalë vetëm për një takim të shkurtër, por çdo takim ka efekt të qëndrueshëm prandaj të sillemi mirë dhe me kujdes “me të pavdekshmit me të cilët punojmë së bashku...” (CS Lewis).

NASA është e përgjegjshme edhe për deklaratën tepër të fortë që “për dështim nuk bëhet fjalë”. Kjo fjali vjen nga skuadra e qendrës drejtuese tokësore Apollo 13, drejtuesi i të cilës ishte Gene Kranz. Ai arriti t’i

kthente në rregull të tre astronautët pavarësisht nga fatkeqësitë e shumta katastrofale. Për FOREVER-in dështimi nuk ekziston. Natyrisht këtu nuk bëhet fjalë për jetë a vdekje si në rastin e astronautëve të Apollo 13. Por FOREVER është ajo me të cilën merremi dhe e cila është e rëndësishme për ne, prandaj punën tonë duhet ta vazhdojmë me të njëjtin pasion dhe entuziazëm siç e bënë heronjtë kozmik të NASA-s. Është tepër inspiruese të mendosh se njerëz si Ju apo unë jemi në gjendje t’i zgjerojmë kufijtë tanë!

GJITHMONË E MË LART: ky është pikësynimi kryesor i 2006–ës dhe 2007–ës. I nxit të gjithë të ngjiten mbi sfidat dhe stuhitë, mbi atë që shpresojnë, dhe me këtë ta vendosin biznesin e tyre në një nivel të ri.

Çfarë prisni akoma? Lidheni rripin e sigurimit dhe iu uroj të gjithëve një vit fantastik!


REX MAUGHAN

Përfundoi edhe një Super Rally tjetër i cili ishte gjithashtu i shkëlqyer! Të jesh mes distributorëve më të mirë të botës është gjithmonë një mbresë e mrekullueshme. Jam i sigurt se edhe Ju do t’i pëlqeni materialet mësimore dhe produktet e reja që prezantuar këtu.

Sivjet Super Rally ishte në Houston të Teksasit, në qytetin e NASA-s. NASA u tregoi njerëzve se si e mposhti gravitetin për t’u ngjitur lart e më lart, më lart se ç’imagjinohej. Qendra drejtuese tokësore e NASA-s ndihmoi Neil Armstrong dhe Buzz Aldrin që të ishin njerëzit e parë që u ngjitën në hënë. Atë ditë në hapsirë ishte edhe një hero i tretë: Michael Collins, një pilot dhe astronaut me përvojë, të cilit i kërkuan të qëndrojë në anije



4x3... Mrekullia e realizuar!

Skuadra hungareze, sllavo-jugore dhe shqiptare e Forever Living Products në Super Rally-n Ndërkombëtar të 2006-ës dha përsëri provim shkëlqyeshëm. Kësaj radhe për herë të katërt pas Dallasit, San Diegos dhe Las Vegasit kjo skuadër u radhit në vendin e tretë në garën mes 120 shteteve në Houston. U realizua një mrekulli e cila është përmbledhja e mrekullive të vogla të përditshme të disa dhjetra e qindra bashkëpunonjësve. Na përgëzoi me respekt dhe dashamirësi gjithë bota, distributorët hungarez që jetojnë në Amerikë dhe natyrisht gjithë stafi drejtues i FLP International.

Nga ky rezultat del një diçka tepër e rëndësishme: nuk ndërtuam kasolle prej kashte, por një rrjet madhështor dhe stabil blerësish të kënaqur pas të cilit qëndrojnë drejtues të shkëlqyer të angazhuar të cilët ndiqen nga një gjeneratë e re, e zellshme, e hapur dhe e aftë për zhvillime të mëdha. Nga dita në ditë, nga ora në orë shfaqen fytyra të reja, dëshira të reja, mundësi të reja, dhe është detyra jonë t'i ndihmojmë ata në rrugën e re, t'i ndihmojmë, t'i lemë të fluturojnë, të mos i tërheqim prapa por t'i hedhim në lartësi të mëdha. Në këtë mënyrë edhe ata mund ta përjetojnë mrekullinë që biznesi Forever u ofron më shumë se 8 milion e gjysëm punonjësve të tij në gjithë botën.

Nga viti në vit, nga muaji në muaj ashtu si kudo, edhe në Forever forcohet konkurrenca. Na ndjekin sfidues të rinj dhe konkurues të dashur si Skandinavia, Meksika, Brazili, kurse ne nxitojmë pas



Gjermanisë dhe Japonisë. Është një ndjenjë e mrekullueshme të marrësh pjesë në një garë të tillë. Kampionati ynë botëror i vitit të ardhshëm do të jetë në Los Angeles, në Anaheim, ku do të konkurojmë për herë të pestë për një vend podiumi. Ne jemi gati për këtë garë, në çdo orë dhe minutë punojmë për të. Ti që e mban për herë të parë në dorë revistën e Forever-it, a je gati për garë? Shfrytëzoje rastin sepse mundësia qëndron vetëm njëherë përpara teje, jeta të dhuron vetëm njëherë një mrekulli dhe ndoshta Ti as nuk e ke vënë re atë... Ndiq ata të cilët e përfaqësuan me dinjitet vendin në këtë Rally, të cilët u përkasin ndërtuesve më të mëdhenj të rrjetit Forever në botë: diamant-safir managerin **Miklos Berkics (5000 cc)**, diamant managerët **Veronika dhe Stevo Lomjanski (5000 cc)**, safir managerin **Robert Varga (5000 cc)**, safir manageren **Agnes Krizso (7500 cc)** dhe safir managerët **Jozsef Szabo dhe Marika Szabone (10000 cc)** që zotërojnë rrjetin e pestë më të madh në botë, mëso nga gjenerata e re e cila sjell ritëm të ri në Forever, Adolf L. Kosa, safir managerët e sapokualifikuar

në Super Rally, soaring dhe senior managerët e rinj.

Natyrisht më shumë mund të mësojmë nga një njeri i cili na duket sikur në çdo moment është me ne, me mendimet e tij përpiqet të ndihmojë dhe të thjeshtëjë punën tonë, të zgjerojë numrin e mundësive të mëdha ekzistuese, tek i cili mund të mbështetemi vazhdimisht, ai është sponsori i gjithë anëtarëve të Forever-it, presidenti-drejtori i përgjithshëm i Forever Living Products International, Rex Maughan. E falenderojmë për ndihmën, humorin dhe forcën e tij të përditshme!

Mundësia, mrekullia e re është e dhënë, ne jemi gati për të të pranuar, bëhu edhe Ti pjesë e asaj që edhe në 2007-ën të ngjitemi në podiumin e Forever-it dhe që flamuri ynë të valëvitet në Los Angeles.

Përpara FLP Hungari!

DR. SANDOR MILESZ
drejtor gjeneral





**ISTVAN HALMI DHE
RITA MIKOLA HALMINE**

soaring managerë
anëtarë të President's Club

Të jetosh, të fluturosh. Ishte një kohë kur këto të dyja kishin të njëjtën kuptim për mua. Në shkollën e lartë kur isha plot me ëndrra, dëshira dhe krahë të hapura. Po mësoja për t'u bërë pilot. Edhe FLP-ja në atë kohë i nxorri krahët, pasi bëhet fjalë për vitet tetëdhjetë, me gëzimet dhe hidhërimet e tyre.

TO LIVE, – në nivelin

Kaluan disa vite. Dëshirat u harruan, pastaj u zgjuan përsëri. FLP-ja i nxorri përsëri në pah. To live, to fly. Një parrullë rreth të cilës u ndërtua viti i kaluar i FLP-së i cili tani u kurorëzua nga Super Rally në Houston. Por çfarë do të thotë kjo parrullë? A do të thoshte për të gjithë aq sa për mua? Vështirë!

Në Houston ishim pjesë e një mrekullie të cilën është e vështirë ta përshkruash

me fjalë. Pas një udhëtimi me aeroplan pa komplikime dhe valixhe të humbura mbërritëm pasdite në qytetin e katërt më të madh të Amerikës, në Houston. U nisëm në mëngjes dhe mbërritëm pasdite. Kjo edhe po të marrim parasysht ndryshimin prej 7 orësh të kohës të duket e pabesueshme. Falë organizatorëve.

Në Hilton – ku tjetër – ku na prisnin punonjësit amerikanë të Forever-





FOREVER



TO FLY më të lartë!

it, na çuan menjëherë me autobusa.
Dhe ishim afërsisht 4000 vetë nga e
gjithë bota!

S'mjaftonte që në shtëpi na dërguan
në llogaritë tona bankare para për
të shpenzuar, por udhëtarët e parë
u çuditën kur panë se morrëm një
valixhe me rrota plot me produkte FLP-
je. Me xhel, shampo, lips, fast break,
pastë dhëmbësh, fletore shënimesh,
stilolaps, pulover uniform, dhe kush e

di se çfarë tjetër. Ai që na dha valixhen
tonë ishte pikërisht Gregg-u. Për t'u
çuditur, megjithëse tani në rrugën e
katërt aspak e pazakontë, por ishte një
ndjenjë tepër e mirë! Hi my friend, how
are You? (si të jem pas një vëmendje
dhe kujdesi të tillë në Amerikë, në
Hilton, i shërbyer nga djali i pronarit të
FLP-së?) Fine, thank You, por më mirë
do të përshëndesja kudo në botë ata që
s'besojnë dhe dyshojnë: unë jam këtu
me bashkëshorten time kurse Ti rri kot



FOREVER 






FOREVER

në shtëpi! (Ëhë, sepse nuk funksionon, të gjithë me këtë merren, ka edhe më mirë, produkt më të mirë, biznes më të mirë. . . Ku je tani? Dhe ku po shkon?)

Ne ishëm aty me 200 vetë nga Hungaria mes më të mirëve. Të kualifikuar të rinj erdhën me ne: safir manageri Dr. Adolf L. Kosa; soaring managerët Tibor Elias, Adam Kibedi dhe Emőke Otos, Imre Papp dhe Aniko Peterbencze; senior managerët Dr. Renate Steiner, Csaba Juhasz, Ilona Orosz dhe Dr. Zsolt Göczi, Janos Tamas dhe managerja Marianna Szasz. Darkë pritje fantastike, mëngjese të shkëlqyer, seminare të pabesueshëm, vlerësime. Gjithçka në nivelin më të lartë. Më kot, duhet të dish të jetosh!



Përveç zbulimeve gjeniale (me një anije kozmike në sfond) aktivitetet dhe vlerësimet kishin edhe programe të shkëlqyera.

Në ditën e dytë provuam produktet e reja. Na prezantuan të ardhmen nëpërmjet internetit duke u dhënë çdo ndihmë të nevojshme konsumatorëve dhe ndërtuesve të rrjetit. Pija energjike dhe e shëndetit Aloe 2 Go në shishe 1 decilitër është një ide gjeniale. Nuk duhet të mendohem më se ku ta marrë Xhelin dhe Pomesteenin për 3 ditë apo çfarë të pi pas futbollit. Mungesat i zëvendëson Nature's 18 e cila përmban përzierjen e 18 perimeve dhe frutave të zgjedhura në paketim ditor dhe mujor.

Në fund të ditës mes fishekzjarreve të mëdha prezantuan simbolin e ri të FLP-së, SHQIPONJËN me aloen në kthetrat e saj. SHQIPONJËN e cila është zogu më fisnik dhe fluturon mbi të gjithë. E cila nuk e ndërron partnerin e saj por i qëndron qëndron përgjithmonë pranë. E kupton? FOREVER! Gjuetarja më e madhe e cila nga 14 gjueti vetëm njëherë kthehet me sukses në shtëpi – por prapë nuk qahet që gjuetia nuk i ecën. Tregu është plot, të gjithë bëjnë të njëjtën gjë dhe tashmë çdo shqiponjë ka lepurin e saj. . .

Në ditën e tretë dhe të katërt ishin lavdërimet për çdo shtet. E pabesueshme por rrjetndërtuesi i katërt më i madh i Amerikës është një çift hungarez! Urime Norbi dhe Anita, jeni të shkëlqyer, keni një skuadër të shkëlqyer dhe një linjë sponsorizuese të veçantë, po përmend vetëm çiftin Rozsahegyi, Sanyi Toth-in, Miki Berkics-in apo Joska Szabo-n. Të jeni krenar, pasi edhe ne krenohemi me të gjithë ju!

Rex i uroi të gjithë me radhë, çdo femre i puthi dorën dhe doli fotografi me me të gjithë. Si mund ta duronte këtë ngarkesë pa produktet e tij?

Ne, hungarezët falë punës së madhe dhe drejtimit të shkëlqyer arritëm përsëri vendin e tretë në botë për qarkullimin, gjë e cila do të ishte e pabesueshme po të mos dinim se: ne kemi çmimet më të shumta Nobel, kryesojmë në sport, kulturë, dhe pothuajse gjithçka apo baza e gjithçkaje është zbuluar nga njeri hungarez, duke patur parasys sferën, kompjuterin, karrocën, makinën, aeroplanin, plugun e deri tek parashuta. . . U përkasim më të mirëve të botës, pra të veprojme kështu: të fluturojmë lart si shqiponja, të punojmë dhe të jetojmë në nivelin më të lartë!



Gjera të tilla mund të ketë parë dhe ndjerë njeriu i zakonshëm në këto ditë – nëse ishte me ne në Houston.

Unë si pilot i dikurshëm kam parë dhe ndjerë edhe gjëra të tjera. M'u plotësua një nga ëndrrat e mia të mëdha pasi hymë në Qendrën Kozmike të NASA-s, në fortesën e fluturimit. Pamë simulantët e përgatitjeve për fluturimet kozmike, u bëmë pjesë e historisë së fluturimit. Qëndrova dhe i bëra homazhe me lot

heronjve të anijes së parë kozmike të rrëzuar Challenger. (Ta dini që edhe në kohën e komunizmit, kur u rrëzua kjo mrekulli e fluturimit, ne pilotët nxënës e qamë dhe i dërguam telegram ngushëllimi qeverisë së atëhershme të Shteteve të Bashkuara. Ishte një ngushëllim i vërtetë me lot të vërtetë për të cilin për pak sa nuk na përjashtuan nga shkolla e lartë. Tani na respektojnë edhe ata që donin të na përjashtonin, por më kot, e tillë është jeta. . .) Lotët e mi u derdhën për shokët e mi pilotë të rrëzuar, të njohur e të panjohur, të cilët e provuan: to live, to fly është e njëjta gjë. Ishim aty, Unë dhe Rita, së bashku si në shumë varrime.

Por tani rilindëm sepse ata që kishin mundësi – më saktë ata që u përpoqën për të – si psh. nga skuadra jonë Dr. Zsolt Gönczi, Ilona Orosz, Janos Tamas, Andi dhe Csaba Toth, e ndjenë se ç'do të thotë: To live, to fly! Ç'do të thotë ta bësh këtë në nivelin më të lartë, pasi kështu ia vlen. Falenderojmë drejtorin gjeneral Dr. Sandor Milesz-in, linjën sponsorizuese, Teca dhe Sanyi

Herman-in, Tamas Biro-n, me të cilët filluam fluturimin, Zoli Becz-in, Moni-n, Ari Vagasi-n e cila e di gjithmonë se ku është butoni ynë drejtues, Miki Berkics-in i cili na freskon kur nxehemi shumë, dhe Jozsi dhe Marika Szabon, miqtë tanë të vërtetë. Falenderojmë linjat vëllazërore dhe frymëzuesit, por falenderojmë edhe dyshuesit sepse na vunë në funksion motorrin shtesë "vetëm sepse".

Por përpara të gjithëve falenderojmë njëri-tjetrin që jemi dhe duhemi, dhe që nuk duhet t'u kushtojmë vëmendje grindjeve të vogla të përditshme. Mjafton ta shohim njëri-tjetrin në sy, të shtrëngojmë dorën e njëri-tjetrit, të fëmijëve tanë dhe të ndjekim mentalitetin e Rex-it. Tani deri në Los Angeles, deri në Anaheim, dhe: See You in Hawaii!





FOREVER





**MARTA ZSIGA DHE
ISTVAN TOTH**

senior managerë
anëtarë të President's Club

**2 gusht, e mërkurë ora katër
e gjysëm e mëngjesit, në
aeroportin e Ferihygyi-t me
emocion të madh presim të
nisemi në Rally në Amerikë.
E kemi pritur prej vitesh këtë
udhëtim dhe me sa duket tani
u poqëm për këtë.**



POST RALLY



Pas një udhëtimi të gjatë më në fund arritëm në Houston. Në katër ditët e para ishim afërsisht 200 vetë që përfaqësonim rajonin tonë në demonstrimin shumëngjyrësh ku merrnin pjesë 6000 persona. U njohëm me produktet më të reja, idetë e të ardhmes së kompanisë sonë, distributorët me të suksesshëm në botë dhe jo në radhë të fundit simbolin e ri, shqiponjën e cila me një gjethe aloe nën kthetrat e saj fluturon gjithmonë e më lart. Të gjithë ishim të një mendje se Rex-i kishte vendosur përsëri mirë, ky simbol do ta

përfaqësojë me dinjitet mentalitetin e kompanisë sonë!

Na çuan në qendrën e NASA-s në Houston ku kaluam një pasdite të këndshme në një vend me rëndësi historike.

Me kalimin e katër ditëve skuadra u përça pak, pasi kishte nga ata që morrën drejtimin për në shtëpi, shumë të tjerë u përgatitën për në Silver Rally, kurse ne me nëntëmbëdhjetë vetë nga rajoni u bashkuam me një skuadër prej 260 personash dhe morrëm pjesë në





FOREVER



TRADICIONAL

Rally-n Tradicional. Dhe nuk ndaluan deri në McAllen ku morrëm pjesë në një darkë të papërsëritshme meksikane nga e cila u kthyem në hotel me dhurata dhe sende të vogla popullore. Ditën tjetër pamë një pjesë të bimëve të mbjella dhe një fabrikë stabilizimi, pastaj pasi hëngrëm drekë u ngjitëm përsëri në aeroplan dhe në mënyrë pak të komplikuar arritëm në Dallas. (Me që ra fjala gjatë dhjetë ditëve fluturuam dhjetë herë me aeroplan.) Për shkak të vonesës u përgatitëm shpejt e shpejt dhe u nisëm menjëherë për në South Fork Ranch ku siç u shpreh Miki hëngrëm steak-un më të shijshëm në botë. Pamë shtëpinë ku në atë kohë "jetonte" familja Ewing, disa nga vajzat mund të thonë që janë shtrirë në kravatin e Jockey-t, kurse Miki siguroi ndoshta unazën me diamantin më të madh në botë! Në mëngjes pamë fabrikën e përpunimit ku ishte diçka e mahnitshme të shikoje rrjedhshmërinë e punës, organizimin profesional dhe kapacitetin madhështor. Pamë një



rrugë të tërë plot me magazina të mbushura me produkte të grumbulluara në kate të cilat nuk qëndronin aty më shumë se javë. Pasi hëngrëm picën e mrekullueshme dhe konsumuam pa masë xhel u gjetëm përsëri në aeroplan dhe iu drejtuan Phoenixit. Pasi zumë dhomat në hotelin Scottsdale Plaza dhe u mahnitëm nga mjedisi i mrekullueshëm, na çuan me autobusa në një qendër tregëtare ku secili mund të blinte sipas qejfit. Në darkë

u freskuam në pishinën e hotelit. Në mëngjes në Robson Honey pamë se si përgatiten produktet e kosheres së bletës dhe një pjesë e tabletave. Programin e mëpasshëm të gjithë e prisnin me shumë kureshtje, shkuam në qendrën e kompanisë, në Home Office. Në qendrën kryesore që gjendej në një mjedis të mrekullueshëm patëm mundësi të ulemi në karrigen e Rex-it dhe të njihemi me gjithë drejtuesit (Navaz, Dr.Z, Rjay, stb.) të cilëve u dimë për faleminderit një pjesë të suksesit tonë, pasi ata e koordinojnë gjithë





biznesin në mënyrë që Ne misionerëve të na shkojë sa më rrjedhshëm puna. Duke parë këtë ambient mendoj se Rex-i bën gjithçka që të gjithë punonjësit ta ndejnë mirë veten dhe me njohuritë dhe punën e tyre të kontribuojnë në suksesin e kompanisë sonë. Çfarë ndodhi pas drekës? Po, u nisëm për në aeroport që të arrijmë sa më shpejt në stacionin tonë të fundit, në Las Vegas ku kaluam dy netë. Kush e mban mend se si ishte parku i lojrave për herë të parë kur ishim fëmijë, ku u mahnitëm nga rrotullamet me ngjyra dhe dritat e shumta? Pak a shumë kështu e ndjemë veten kur shkuaam me autobus përmes qytetit. Gumëzhinte gjithë autobusi: -e shikoni, -shiko atje,



çfarë mrekullie, -o, çfarë bëhet! Hoteli ku na çoi kompania ishte vendi ku u mbajt Silver Rally i vjetshëm, hoteli Venetian i cili është një nga hotelet më të mirë të Las Vegasit! Pasditja kaloi duke u mrekulluar me kasinon, Sheshin e Shën Markut (s'është gabim, në katin e dytë dhe të gjashtë të hotelit kanë ndërtuar një Venecie të vogël me laguna, gondola, sheshin Shën Mark dhe gjithë kjo ka edhe qiellin e saj i cili rrezaton dritë edhe në mes të natës, madje në të lëviznin edhe re!), si dhe morrëm hartën që na drejtonte drejt vendit ku duhet të shkonim të nesërmen në mëngjes! Miki e thirri gjithë shoqërinë (aty nuk ishim linja





FOREVER



vëllazërore, por SHOKË) në orën nëntë pa një çerek përpara hotelit ku erdhi një limuzinë Hummer e mrekullueshme, me ngjyrë të verdhë dhe dymbëdhjetë metra e gjatë. Pasi u zgjuam nga mahnitja, bëmë një fotografi të shpejtë me limuzinën në sfond dhe u nisëm. Shkuam pranë radhës së hoteleve të njohura të Vegasit dhe ishte një ndjenjë fantastike të shikoje se si turma e njerëzve në rrugë kthehej për të parë makinën tonë. Në emër të të gjithëve të falenderojmë Miki për këtë ndjenjë të paharrueshme dhe që erdhe me ne në këtë rrugë!

Pasi hëngrëm mëngjes herët u nisëm me autobusa për në Black Canyon ku në Hoover dam (diga e parë e ndërtuar në Amerikë) hipëm në gomone të mëdha dhe përshkuam një pjesë të vogël të këtij lumi të mrekullueshëm në Colorado. Zbarkuam në një nga portet e kompanisë pasi morrëm disa freskuese dhe fruta u ulëm në varka më të vogla, por shumëherë më të shpejta, gjashtë personëshe, dhe duke lenë prapa brigje njëri më i bukur se tjetri, pas një udhëtimi prej gjysëm ore arritëm në parajsën e pushimit të kompanisë Cottonwood Cove & Marina. U gjetëm përsëri në një vend të mrekullueshëm ku na pritën me një drekë të bollëshme, pastaj u lamë, kurse unë shkova të përkëdhel peshqit! Pas dy orësh u kthyem për në qytet ku

në mbrëmje në një nga tre teatret e mëdha të hotelit pamë operën me titull Fantomi i Operas. Shumë prej nesh e kishin parë atë edhe në shtëpi dhe atyre u mungonte vetëm zëri i Sandor Sasvari-t, por në përgjithësi shfaqja ia kalonte asaj të Budapestit për shkak të elementeve dhe efekteve spektakolare. Pas shfaqjes shumë vetë u nisën të shikonin qytetin që të ktheheshin me sa më shumë mbresa në shtëpi, kurse të tjerët vizituan pjesë të ndryshme të hotelit ose u morrën me paketimin.

Në mëngjes herët u nisëm për në aeroport dhe nëpërmjet Deneverit me ndalesë në Frankfurt u kthyem në shtëpi pas një udhëtimi prej 26 orësh.

Ky udhëtim ishte mbresa më e madhe e jetës sonë deritani gjatë të cilit provuam, pamë dhe mësuam shumë gjëra!

I nxit të gjithë të punojnë për pikësynimet e tyre, arritjet e të cilave do të sjellin si rezultat një udhëtim të tillë të organizuar dhe të paguar nga kompania!

Edhe ne nuk do të kishim përfunduar dot këtu nëse miku ynë Vilmos Halomhegyi nuk do të na i tregonte këtë mundësi dhe nuk do të na niste në këtë rrugë, apo po mos të kishim përreth skuadrën e zellshme, miqtë e shumtë me të cilët krenohemi dhe pa të cilët nuk do ta kishim arritur dot. Ju falenderojmë të gjithëve!





**MIHALY SZEP DHE EVA
KESZI SZEPNE**

soaring managerë

“Dhe mrekullitë ekzistojnë!”

**Shumë njerëz dyshojnë në
ekzistencën e mrekullive,
por tek FLP-ja mund të
përrjetosh nga dita në ditë
mrekulli gjithmonë e më të
mëdha.**

SILVER POST - udhëtimi me anije

Unë s'e besoja... Kur e lidhëm jetën me njëri-tjetrin, kur e lidhëm jetën tonë me FOREVER-in nuk e besonim se në gusht të 2006-ës mund të marrim pjesë në një udhëtim ëndërr me një anije lluksoze në detin e Karaibeve, dhe për më tepër gjithë këtë e morrëm si dhuratë.

Kur filloi? Gusht 2003 Branson, 2004 Cancun, 2005 Las Vegas, 2006 ishulli i Meksikës. Nuk e kishim kuptuar akoma se çfarë po marrim plus nga Rex-i dhe Gregg-u, nga FLP-ja.

UDHËTIM SHPËRBLIM – PUSHIME VERORE SHPËRBLIM

Sikur drejtuesit e FLP-së e njihnin thënien hungareze: “Pas punës është e ëmbël shplohja”. Na ëmbëlsojnë jetën, na mbushin me vlerësime, dashamirësi dhe përkujdes.

Por çfarë është në të vërtetë Silver Post Rally?

Distributorin që realizon të paktën 2500 pikë në vitin e biznesit, FLP-ja e çon si shpërblim së bashku me partnerin e tij për pushime verore 6 ditore. E them seriozisht se në vitin 2003 as që e kuptuam se ç'do të thotë kjo. Shumë prej nesh tani e kuptuan

që Rex Maughan dhe Gregg Maughan na mahnitën përsëri me faktin që qëndrojnë gjithmonë përpara nesh në dhënien e shembullit. I vlerësojnë dhe i shërbejnë me një respekt të jashtëzakonshëm njerëzisë së tyre. Vetëm një shembull: Gregg dhe Gerryn në darkën (tepër të shijshme)





FOREVER



SILVER POST RALLY në detin e Karaibeve

e mirëseardhjes i regjistruan vetë 350 anëtarët e Silver Post Rally-t dhe na ndanë me duart e tyre paketën e dytë të dhuratave gjatë udhëtimit tonë e cila kishte brenda produkte që të mos kishim probleme gjatë pushimeve tona. Edhe një plus i vogël: në anije na prisnin edhe 100 \$ para xhepi të cilat

mund t'i shpenzonim sipas qejfit përveç shërbimit të plotë që na jepej.

Si ishte anija? Imagjinoni një qytezë që noton, me 12 kate, 300 metra të gjatë, 100 metra të gjerë, me një peshë 7500 tonësh, ku gjithçka shërben komfortin dhe argëtimin e udhëtarëve. 1500

udhëtarë shërbeheshin nga një personel prej 1000 personash. Përveç kapitenit të anijes dhe ekuipazhit të tij prej 20 personash kamarierët e restoranteve, shërbyesit e kabinave, një gardë e tërë këngëtarësh, muzikantësh dhe kërcimtarësh (afërsisht 40 persona), fotografë, 15-20 shitës dyqanesh të





ndryshme dhe të tjerë rreth të cilëve nuk kishim dijeni, shërbenin me angazhim të plotë komfortin e udhëtarëve në anije. Në tarracat e banjës së diellit pranë pishinave kamarierët me humor të këndshëm shërbenin kokteile. Çdo pasdite në skenën e hapur luhej muzikë e drejtpërdrejtë regje. Darka ishte pika kulminante e ditës pasi në restorantin prej 500 personash shijonim ushqimet e magjishme të shërbyera në mënyrë elegante. Çdo tavolinë kishte dy kamarierët e saj dhe në fund të darkës kamarierët jepnin shfaqje, këndonin, kërcenin dhe na argëtonin. Në darkë pas orës 10 ishte periudha e argëtimit të natës, pasi nga ora 11 pa një çerek argëtoheshim nga shfaqje me muzikë dhe kërcime në sallën e teatrit prej 400 personash. Dhe ai që nuk flinte dot mund të shijonte në bord aromën dhe dritat e detit natën.

Gjatë rrugës me anije përfundam në Meksikë, në dy pika të njohura të gadishullit Yucatan, në qytetin Progreso

dhe Cozumel. Ky i fundit është parajsë më e bukur në Meksikë, dhe e dyta në botë e zhytjes nën ujë. Ai që kishte mundësi u zhyt ndërmjet koraleve dhe peshqëve me ngjyra të mrekullueshme, shijoi lëkundjen e këndshme të detit të ngrohtë, ose fluturoi me motorr xhetski, ose thjesht mrekullohej nga deti i magjishëm blu i ishullit të Meksikës. Ngjyrë e tillë blu mund të shikohet vetëm në kartolina. Po këtu? Këtu të shfaqet vetë kartolina dhe Ti je personazhi kryesor i saj.

Çfarë është nëse jo mrekulli? Drejtuesit e FLP-së ishin deri në fund me ne dhe krijuan dy forume ku u konzultuan me distributorët drejtues. Takimi i parë i tillë ishte në Silver Post Rally-n e Las Vegasit ku nga distributorët më të mirë kërkuan opinione dhe rekomandime disa prej të cilave u realizuan në Rally-n e sivjetshëm. Në takimin e parë ishte së bashku gjithë skuadra udhëtuese. Paraditja kaloi në një atmosferë të shkëlqyer dhe u diskutuan shumë rekomandime të rëndësishme. Në forumin e dytë u ulën së bashku distributorët me 7500 dhe 10000 pikë që bashkë me drejtuesit e kompanisë të diskutonin çështjet më të rëndësishme. Ishte një kënaqësi dhe krenari e madhe për skuadrën hungareze që 3 nga distributorët tanë morrën pjesë në takimin e 18 distributorëve më të suksesshëm të botës: Marika dhe Jozsef Szabo, Veronika dhe Stevan Lomjanski, dhe Agnes Krizso.

Në pasditen e fundit biseduam me çdo udhëtar, dikë e takuam në pishinë, dikë gjatë banjës së diellit apo në bar, kishte nga ata që po bënin gati valixhet, por është e sigurt që nuk lamë asnjëri.

Safir managerët Marika dhe Jozsef Szabo


– Përse ia vlen ta bësh?

- Për jetën, fatin dhe ëndrrat e tua!
- **Çfarë u thua atyre që janë në shtëpi?**
- Zgjidh shembullin e duhur, ndiq vetëm njerëzit jeta dhe puna e të cilëve të pëlqen.

Diamant managerët Veronika dhe Stevan Lomjanski

– Përse ia vlen?

- Nëse merresh me FLP-në në mënyrë profesionale atëherë duhet të jesh këtu me ne, sepse nëse s'je këtu atëherë puna jote nuk është punë profesionale! Më pëlqeu shumë gjithë udhëtimi me anije sepse s'kam qenë asnjëherë në një udhëtim të tillë. Më shkaktoi kënaqësi të madhe veçanërisht fakti që ndodheshim në anije mes 8 milion distributorësh dhe që së bashku me ne pushonin edhe 2 bashkëpunonjës dhe sponsorët tanë.





Safir managerët

Marija dhe Cvetko Ratkovic

– *Si e ndjeni veten në anije?*

– Është një ndjenjë e mirë që u përkasim më të mirëve në rajonin tonë dhe në gjithë botën.

Soaring managerët

Marija dhe Bosko Burus


– *Çfarë mendimi ke për udhëtimin shpërblim Silver Post Rally?*

– Kjo është një dhuratë e vërtetë. Këtë punë do ta bëja edhe nëse nuk do të ishte ky shpërblim plus: Një “shef” i tillë si Rex-i nuk ka tjetër në botë. Të paguan dhe të shpërblen për çdo gjë që bën.

Safir manageri Istvan Utasi

– *Çfarë mendimi ke për sistemin e vlerësimit në bazë të pikëve?*

– Jam dakort me të. Është një “pasqyrë” e mirë. Jemi krenar që në të pestë kategoritë (1500, 2500, 5000, 7500, 10000) ka distributorë hungarez.



Më lindi dëshira të hyj në grupin e mëpasshëm. Bëra pak llogari në bazë të qarkullimit dhe arrita në përfundimin se s’ka kompani tjetër si FLP-ja e cila ndan kaq shumë gjëra me distributorët e saj. Duket që distributori është vlera më e madhe.

Soaring managerët

Istvan Halmi dhe Rita Mikola

– *Me çfarë mbresash po ktheheni në shtëpi?*

– Ishullin Cozumel e përshkuam me një Jeep të marrë me qira, ishte një argëtim i vërtetë. Atyre që ndodhen në shtëpi iu them se në Super Rally-n e ardhshëm në Las Vegas është mirë të vijmë edhe ata që nuk e meritojnë plotësisht këtë udhëtim, që ta kuptojnë se këtë mundësi nuk ia vlen ta lëjmë pas dore asnjëherë.

Soaring manageri Zsolt Fekete

– *Iu pëlqeu udhëtimi shpërblim?*


– Është një atmosferë e argjendit! Të vlerësohet puna me të cilën për një vit me radhë ke mbajtur bashkuar skuadrën tënde, ke motivuar dhe ndihmuar managerët e tu. Me këtë sistem vlerësimi FLP-ja vlerëson dhe stimulon mendimin me afat të gjatë kohe dhe ndërtimin e biznesit stabil. U këshilloj të gjithëve nga zemra që të shikojnë aktivitetet ndërkombëtare të kompanisë dhe të rrisin shpejtësinë drejt tyre!

Diamant-safir managerët

Aranka Vagasi dhe Andras Kovacs

– *Përse ia vlen ta realizosh këtë?*

– Ia vlen t’i kalosh shpeshherë 2500 pikët pasi çdo vit mund ta shijojmë në vende të ndryshme shpërblimin e Rex-it i cili shumëfishohet në



shpirtin tonë. Shpërblim i madh për një rezultat të madh. Asnjëherë nuk e kisha menduar se do ta shikoja përfundimin e diellit duke u relaksuar në një anije.

Soaring manageri Tibor Elias

– *Si e ndjen veten?*

– Ishte një silver super. Shplohja e plotë dhe qyteti i vogël Cozumel i Meksikës ishte një nga mbresat më të mëdha të jetës sime. Ishte diçka fantastike mundësia e njohjes së kulturës së lashtë të një kombi tjetër. Gjatë një pushimi të tillë veror mund të shplohesh plotësisht. Dhe kthehesh i ripërtërirë në punë.

Safir manageri Robert Varga

– *Çfarë mendimi ke për udhëtimin shpërblim Silver Post Rally?*

– Është një ide e mirë nga kompania që krijon nivele të ndryshme në mënyrë që edhe mes managerëve në pozicione të rehatshme të krijohet konkurrencë. Tashmë kjo përbën më

tepër se të ardhurat e mira me arritjen e mbi 2000 pikëve në vit. Kjo është një garë mes managerëve të vërtetë. Edhe mes managerëve përbën ndryshim arritja e 125 pikëve apo 210 pikëve në muaj. Për këtë të fundit nevojitet kualifikim manageri. Që dikush ta arrijë këtë duhet të mësojë dhe të përgatitet. 2500 pikë nuk arrihen me forcë. Është fantastike që drejtuesit e kompanisë na shërbyen me respekt të madh, na treguan një shembull të cilin edhe ne duhet ta ndjekim, ta kopjojmë dhe ta bëjmë. Ia ku është miliardi që shikon, ndihmon dhe ndan pakot. . .

Soaring managerët

Marika dhe Zsolt Rozahegyi

– *Përse ia vlen ta bësh?*

– Për të provuar ndjenjën e mrekullueshme të jesh pranë drejtuesve të kompanisë dhe të ndjekësh shembullin e tyre: Rex-it dhe Gregg-ut. Më pëlqen që shpërblimi jepet në varësi të rendimentit. Është mirë të jesh mes

më të mirëve të FLP-së. Nuk duhet të përpiqesh për medalje, por për ndërtimin e një rrjeti të aftë dhe stabil. Mezi presim që nga skuadra jonë të jenë sa më shumë këtu.

Safir manageri Dr. Adolf L. Kosa

– *Të ndodhi ndonjë aventurë gjatë rrugës?*

– Sigurisht! Qëndron jashtë në rrugë në Merida, vapë e madhe, askund një taksi apo autobus, s'ke gjë me vete veç rrobat e banjosh dhe e di se anija po nisët dhe do të lëjë këtu. Në këtë qytet të panjohur ia bën me dorë në rrugë, qëndron një makinë dhe falë Zotit anija nuk ishte nisur dhe më pritën me duartrokitje 2500 njerëz. Mbresa tjetër e shkëlqyer ishte: të zhyteshe në koralet e dyta më të famshme në botë.

Safir managerja Agnes Krizso

– *Çfarë mendimi ke për Super Rally-n?*

– E ndjej kujdesin e FLP-së për managerët e saj. Na japin liri dhe

relaksim që ta ndjehmë mirë veten. Nuk përpiqen të na i zënë kohën me programe por që të shplodhemi me të vërtetë. Kjo është për ata që punojnë në mënyrë të tillë që me kualifikime stabile japin rezultate afatgjate.

Senior managerja

Terezia Hermann

– *Çfarë iu shkaktoi më shumë kënaqësi?*

– Ishte një mbresë e shkëlqyer që erdha në këtë Rally së bashku me vajzën time. Ishte një ndjenjë fantastike të kaloje një javë me më të mirët e botës.

Safir managerët

Gizella dhe Marius Botis

– *Çfarë u thua atyre që ndodhen në shtëpi?*

– Skuadër, eja me ne! Qenia jote këtu vendoset vetëm në mendjen tënde.

Soaring managerët

Ilona Juronics dhe Geza Varga

– *A e meritojmë?*

– Ashtu si në sport që rezultati shpallet në bazë të rendimentit, edhe FLP-ja në bazë të kësaj vlerëson. Si mendoni 2500 cc gjatë 1 viti a është rendiment i duhur? Ta dish se vendimet e tua e përcaktojnë të nesërmen tënde. FLP-ja është biznesi më i mirë. Shfrytëzoje!

Senior managerët

Arpad Kis-Jakab dhe

Ibolya Toth Kis-Jakabne

– *Ku do të udhëtoje herën tjetër?*

– Hawai, Alaskë, bregu Lindor, kudo.

– *Çfarë u thua atyre që ndodhen në shtëpi?*

– Përpiquni të jeni këtu, bëni gjithçka për t'iu afruar kësaj mrekullie.





Senior managerët

Sandor Toth dhe Edina Vanya

– *Cili është mesazhi yt nga anija?*

– E përfaqësuam me krenari skuadrën hungareze, ishte përsëri ndjenjë e mirë të jesh hungarez! Rex-i është tepër bujar dhe unë jam tepër i lumtur që zgjodha kompaninë FLP. Jemi krenar për managerët hungarez, veçanërisht për çiftin Szabo pasi ata ishin distributorët e 4-t më rezultativ të vitit 2005.

Senior manageri Zsolt Leveleki

– *Çfarë mendimi ke për udhëtimin shpërblim Silver Post Rally?*

– Mua më pëlqen. Është çdo vit një mundësi e shkëlqyer pushimi për distributorët. Është një vlerësim serioz, bëjnë gjithçka që ta ndjejmë mirë veten. Ku do të shkojmë vitin tjetër, ajo s'ka rëndësi, sepse kudo që të shkojmë do të shikojmë se distributorët priten mirë, dhe ky është qëllimi. Që të shplohemi plotësisht. Kurse atyre që ndodhen në shtëpi u them se Jozsi Szabo kishte të drejtë kur tha se kjo është kompania më e ndershme të cilës ia vlen t'i kushtojmë jetën tonë.

Soaring managerët

Andras Bruckner dhe

Dr. Terezia Samu

– *Çfarë mendimi ke për udhëtimin shpërblim Silver Post Rally?*

– Super! Tetë vjet më parë nuk e mendoja se do të shikoja kaq shumë vende të mrekullueshme falë Rex-it: Branson, Cancun, Las Vegas dhe deti i Karaibeve. Është e mrekullueshme ngjyra blu e detit të Karaibeve. Ishte një nga dëshirat e mëdha të jetës sime që njëherë të pushoja në një



anije 7500 tonëshe, dhe kjo dëshirë m'u plotësua. Jemi krenar që në këtë anije ndodhemi së bashku me sponsorin dhe linjën tonë të sipërme. Për rezultatin e ndershëm askund në botë nuk paguajnë kaq!

Derisa folëm me të gjithë perëndoi dielli dhe erdhi nata e fundit. Para se të flija më vinin në mendje përgjigjet. Ishte një mbresë e veçantë t'i merrje në intervistë managerët dhe të dëgjoje mendimet e tyre. Të gjithë mendojnë njëllor por prapë mesazhet e tyre janë të ndryshme.

Mësova shumë prej tyre dhe jam shumë i lumtur që ma besuan mua këtë detyrë.

Shpirti im u mbush nga një ndjenjë e mirë dridhëse: Punojmë në kompaninë Network Marketing më të mirë në botë. Mund ta them pa modesti se në rajonin tonë ndodhen rrjetndërtuesit më të talentuar në botë. Skuadër e shkëlqyer.

Këtu ndodhen njerëzit që i duan produktet, e duan punën e tyre, janë të përkushtuar ndaj kompanisë dhe akoma edhe më të përkushtuar ndaj skuadrës së tyre. Ne nuk do të vinim dot këtu pa skuadrën tonë, pa managerët tanë me të cilët në ditët e zakonshme të javës punojmë së bashku krah për krah me këmbëngulje dhe besnikëri. Falenderojmë skuadrën tonë për punën dhe rezultatet e arritura, dhe besojmë se nga viti në vit do të jemi gjithmonë e më shumë në këto pushime shpërblim.

Filozofia e FLP-së: Familja, Mënyra e Jetesës, Njerëzit. Jeta e familjeve ndryshon dhe bëhet më e mirë, lindin miqësi dhe marrdhënie të përjetshme me shumë vlerë. Jeta e FLP-së është e shkëlqyer. Pyetja të drejtohet edhe ty: A dëshiron të udhëtosh në **klasin e parë** në jetën që të ka mbetur? Nëse përgjigjja jote është po atëherë fillo ta ndërtohet me të vërtetë biznesin tënd FLP dhe bashkohu me skuadrën e suksesit!!!



**DR. TEREZIA SAMU DHE
ANDRAS BRUCKNER**

soaring managerë
anëtarë të President's Club
drejtues programi

Kaluam një Ditë Suksesi të jashtëzakonshme në muajin më të nxehtë të 2006-ës. Pavarësisht nga vapa e madhe me mijëra bashkëpunonjës i shtynë ose i lanë në mes pushimet e tyre për shkak të vlerësimeve. Për këtë përkushtim dhe këmbëngulje respekt për të gjithë pjesëmarrësit. Nxehtësia nuk ndihej vetëm jashtë por edhe në atmosferën brenda sallës falë numrit tepër të madh të bashkëpunonjësve tanë të kualifikuar.

Respekt për këmbënguljen dhe përkushtimin

Drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** në përshëndetjen e tij e informoi publikun rreth rritjes së jashtëzakonshme të qarkullimit të kompanisë gjatë periudhës së kaluar, pastaj dha informata në lidhje me Super Rally-n që po afrohej.

Në skenën e Forever-it pamë grupin e Fëmijëve dhe të Rinjve të Step Dance Sport Club nga Gyergyoszentmiklosi të cilët me një shfaqje sensacionale e ngritën edhe më shumë atmosferën mes publikut. Kërcimet e fëmijëve u shoqëruan nga duartrokitje të mëdha, urime.

Bashkëpunonjësja jonë manager **Dr. Erzsebet Nika** e thirri vëmendjen e publikut të Forever-it për një problem aktual, më saktë ndërmjet shumë efekteve të këndshme të verës për një efekt tepër të pakëndshëm, rritjes së polenit në ajër. Na tregoi se si mund të mbrohemi, si mund të forcojmë organizmin tonë dhe se çfarë mundësisish kemi për ruajtjen e shëndetit tonë. E falenderojmë për leksionin e saj cilësor.

Me drejtimin e bashkëpunonjësës sonë soaring managerë **Dr. Katalin**

Pirkhoffet Dr. Seresne u njohëm me përvojat me produkte që u treguan nga bashkëpunonjësit tanë këtë ditë, si dhe në skenën e Forever-it u prezantuan edhe mjekët të cilët rekomandojnë mënyrën natyrore të jetesës dhe ua kanë kushtuar jetën e tyre ruajtjes së shëndetit në mënyrë natyrore. I falenderojmë për punën e tyre tepër të dobishme dhe të rëndësishme.

Në skenën e Arenës pasoi kualifikimi i **supervisorëve** pastaj i





assistant managerëve. Përgëzime për numrin e madh të punonjësve të kualifikuar dhe u urojmë të takohemi sa më shpejt në skenë në një nivel të ri kualifikimi.

Pas pushimit erdhi koncerti prezantues i diskut të artistes **Ildiko Keresztes** ku u mrekulluam nga talenti i saj i jashtëzakonshëm, shijuam muzikën e saj të mirë dhe e shoqëruam me duartrokitje të mëdha nga skena. E falenderojmë për talentin e saj të jashtëzakonshëm të cilin ia përcjell me qindra mijëra njerëzve.

Managerët **Dr. Laszlo Gancs dhe Dr. Andrea Braun Gancsne** në leksionin e tyre theksuan rolin e rëndësishëm të Rally-ve në punën rrjetndërtuese. Nëse marrim pjesë aktivisht në programet që kanë si pikësynim pjesëmarrjen në Rally, atëherë mund të arrijmë gjithçka gjatë punës sonë, na hapen rrugë e mundësi të reja për arritjen e niveleve të reja. I falenderojmë për leksionin e tyre tepër të rëndësishëm.

Bashkëpunonjësi ynë manager **Zsolt Almasi** me përgjegjësinë dhe precizitetin e tij të zakonshëm skicoi kushtet e Rally-t European të Stockholmit, veprimet që nevojten për plotësimin e tyre dhe gjithë mundësitë që na ndihmojnë për të shkuar në këtë qytet të mrekullueshëm verior. E falenderojmë për leksionin e tij tepër me vlerë.

Në skenën e Forever-it pasuan vlerësimet e **Klubit të Sundimtarëve** gjatë të cilit çmimin e parë e morri bashkëpunonjësja jonë senior managerë **Tünde Ibolya Csaszar.**

Në skenë pasoi **kualifikimi i managerëve** tanë të rinj, pastaj **senior managerët Ferenc Szabo dhe Szabo Ferencne** u lavdëruan nga drejtori gjeneral.

Senior manageri **Karoly Lenart** në leksionin e tij tregoi të gjitha mundësitë që mund të realizohen në jetën tonë të Forever-it, rrugët dhe pikësynimet që ndonjëherë duken si të paarrishme,

por që këtu mes nesh mund të arrihen. Urime për leksionin e tij të bukur.


Soaring manageri **Tibor Radoczki** në leksionin e tij iu drejtua zemrave dhe preki ndjenjat dhe emocionet që ai provon nga dita në ditë gjatë jetës së tij të përkushtuar Forever-it. Leksionin e tij tepër të bukur dhe prekës publiku i Forever-it e falenderoi me duartrokitje të mëdha. Faleminderit Tibor për leksionin tënd të jashtëzakonshëm.

Krisztina Kovacs Jungne në leksionin e saj na sqaroi me hollësi se çfarë është në të vërtetë puna e distributorëve të Forever-it, çfarë duhet të bëjnë nga dita në ditë, cilat janë detyrat e përditshme në qëllim të arritjes së suksesit të plotë. Urime për leksionin e saj tepër me vlerë.

Në skenën e Forever-it **assistant supervisorët** e rinj morrën medaljet e tyre i cili është hapi i parë drejt ndërtimit të rrjetit të vërtetë të Forever-it. Takohemi në skenën e Ditës së ardhme të Suksesit!



FOREVER



FOREVER





**VESNA ČIPE DHE
LASZLO ČIPE**
managerë
drejtues programi

Mysafirët dhe punonjësit më të suksesshëm të Forever Living Products të Serbisë u tërhoqën si me magnet nga Dita e Suksesit (Success Day) e cila ishte dita kulminante e verës. U takuan me kënaqësi sepse ishin të sigurt se do të shkëmbejnë përvoja të reja me njëri-tjetrin dhe do të niseshin me vrull më të madh drejt sukseseve të reja në punë.

Siguri materiale, jetë e qetë

Drejtuesit e programit të aktivitetit tonë ishin bashkëpunonjësit tanë manager nga Novisadi **Vesna dhe Laszlo Čipe**. Me drejtimin e tyre të shkëlqyer tërhoqën vëmendjen e gjithë të pranishmëve dhe i drejtuan ata me sukses nga leksioni në leksion. E falenderojmë çiftin Csipe për drejtimin e përsosur të programit dhe u urojmë që së bashku me skuadrën e tyre t'i arrijnë pikësynimet e tyre në muajt e ardhshëm.

Të pranishmit u përshëndetën me përzemërsi edhe nga drejtuesi tjetër i programit tonë, drejtori rajonal i FLP Serbisë – zoti **Branislav Rajic**. Në përshëndetjen e tij theksoi mundësitë e mëdha që FLP-ja u ofron punonjësve të saj nëpërmjet programeve motivuese dhe shpërblimeve të ndryshme. Jemi të sigurt se shumë punonjës të FLP-së të cilët i shfrytëzojnë këto mundësi arrijnë të realizojnë ëndrrat e tyre.

Tashmë mund ta themi me siguri se **grupi "Garavi sokak"** nga Novisadi i kënaq gjithmonë mysafirët e aktivitetit tonë. Personaliteti i Bane Krstic-it e garanton gjithmonë suksesit e argëtimit. Vizita e tyre ishte një kënaqësi e madhe për ne dhe shpresojmë se do të na

nderojnë rregullisht me pjesëmarrjen e tyre edhe në të ardhmen në aktivitetet e Forever-it.

Përvoja e reja përbëjnë një forcë të madhe në punën e bashkëpunonjësve tanë sepse me zotërimin e tyre mund t'i ndihmojnë më me efektivitet të tjerët dhe mund të kenë më shumë sukses. Në aktivitetet e FLP-së konsumatorët dhe bashkëpunonjësit tanë mjek tregojnë përvoja të mrekullueshme të cilat i sigurojnë gjatë konsumimit dhe përdorimit të përditshëm të paletës së gjerë të produkteve tona të shkëlqyera. Falenderojmë **Dr. Milena Filipovic** e cila e drejtoi në mënyrë të shkëlqyer pjesën e programit të pasur me përvoja me produkte.

Funksionimi i saktë i sistemit qendror nervor është kusht bazë i funksionimit të organizmit të çdo njeriu të shëndetshëm, sepse edhe çrregullimi më i vogël i tij mund të shkaktojë probleme tepër serioze shëndetësore. Këto ndryshime mund të shfaqen tek çdo njeri pavarësisht nga mosha apo gjinia. **Dr. Rozmaring Mirkov** gjatë leksionit të saj shpjegoi se si ndihmojnë produktet e FLP-së në mposhtjen e



vështirësive të dala nga ndryshimet e shfaqura në sistemin qendror nervor.

Skena e Forever Success Day u mbush plotësisht nga **supervisorët, assistant managerët dhe managerët** e sapokualifikuar. Së bashku me skuadrat e tyre festuan kualifikimin e tyre të suksesshëm me të cilin arritën një nivel edhe më të lartë në realizimin e qëllimeve të tyre.

Programeve motivuese të FLP-së u përket edhe aktiviteti gjatë të cilit takohen distributorët më të suksesshëm të gjithë Europës – **Rally European**. Në 2007-ën takimi i punonjësve më të mirë të FLP-së do të bëhet në kryeqytetin e Suedisë, në Stockholm. Punonjësit që kualifikohen me sukses në Programin Motivues me punën e tyre dëshmojnë rreth një rrjeti stabil e të suksesshëm, si dhe rreth një pune skuadër të shkëlqyer. Falenderojmë bashkëpunonjës të tonë soaring manager Bosko Burus për udhëzimet e tij tepër të

sakta sepse me ndihmën e tyre puna jonë mund të kurorëzohet me pjesëmarrjen tonë në Rally-n European. Këshillat e Boskos u pranuan nga të gjithë sepse bashkë me gruan e tij Maria, ata s'kanë munguar nga asnjë aktivitet i tillë.

Siguria materiale, jeta e qetë, puna skuadër dhe pavarësia e madhe gjatë punës janë fakte që na bindën rreth suksesit të bashkëpunonjësve sonë senior manager **Milanka Milovanovic**. Gadishmëria për të ndihmuar është një karakteristikë njerëzore e cila gjatë veprimtarisë në FLP të siguron efektivitet, shëndet dhe baza të sigurta materiale. Me shëndetin mund të japim edhe lumturi.

Çdo njeri është i aftë të ecë në një rrugë e cila drejtohet nga mendja e tij. Dhe kjo mjafton nëse jemi të kënaqur me vendimet tona. Plani Marketing i FLP-së u premtos sukses të gjithë atyre që marrin përsipër përgjegjësinë për

arritjen e qëllimeve të tyre – tha në leksionin e saj bashkëpunonjësja jonë soaring manager **Danijela Ockoljic**.

Ju ftojme me kënaqësi në Forever Success Day-n e ardhshëm të cilën e organizojmë më 16 shtator 2006 në Pallatin e Sindikatave të Beogradit.



BRANISLAV RAJIC
drejtor rajonal



FOREVER



FOREVER





CONQUISTA

Shpërndarësit më të sukses

Klubi i Sundimtarëve

Dhjetë shpërndarësit e parë sipas pikëve personale dhe të non-managerit

HUNGARIA



1. Császár Ibolya Tünde
2. Tanács Ferenc dhe Tanács Ferencné
3. Téglás Gizella
4. Dr. Kósa L. Adolf
5. Gyüre Endre dhe Gyüréné Deák Magdolna
6. Dr. Tombáczné Tanács Erika dhe Dr. Tombácz Attila
7. Túri Lajos dhe Dobó Zsuzsanna
8. Berkics Miklós
9. Börcsök József dhe Börcsökne Monostori Ibolya
10. Révész Tünde dhe Kovács László

SERBIA DHE MALI I ZI



1. Dr. Lazarević Predrag dhe Dr. Lazarević Biserka
2. Glogovac Dragan
3. Ratković Marija dhe Ratković Cvetko
4. Klenkovski Svetlana dhe Klenkovski Branko
5. Cipe Laslo dhe Cipe Vesna
6. Novaković Olga dhe Novaković Slobodan
7. Stojanović Emilija dhe Stojanović Nenad
8. Halas Tijana dhe Halas Leon
9. Švabić Radmila dhe Švabić Radoslav
10. Antonijević Slobodan dhe Antonijević Biljana



ADOR CLUB

sshëm të muajit korrik 2006

KROACIA




1. Sukser Margareta dhe Sukser Marijan
2. Stilin Tihomir dhe Stilin Maja
3. Korenić Manda dhe Korenić Ecio
4. Draščić Dušan dhe Draščić Marija
5. Žutinić Momo dhe Žutinić Mare
6. Jurović Zlatko dhe Jurović Sonja
7. Deković Nevenka dhe Deković Silvano
8. Orinić Marija Magdalena
9. Vidiček Velimir dhe Vidiček Ivka
10. Golubović Karmela dhe Golubović Roman

BOSNIA DHE HERCEGOVINA



1. Mustafić Subhija dhe Mustafić Safet
2. Mišić Cvjeta
3. Dr. Paleksić Slavko dhe Paleksić Mira
4. Smajić Mevludin
5. Njegovanović Svetlana
6. Glavinka Željko
7. Njegovanović Vaselije
8. Varajić Zoran dhe Varajić Snežana
9. Hodžić dr. Sead
10. Đorđević Radmila

SLLOVENIA



1. Arbeiter Jožica dhe Dr. Arbeiter Miran
2. Jazbinšek Tanja
3. Jazbinšek Kim
4. Dr. Herlič Srečko
5. Iskra Rinalda dhe Iskra Lucano
6. Bigec Danica
7. Bizjak Marija
8. Cvijanović Ana dhe Cvijanović Božidar
9. Zitko Ema dhe Zitko Miran
10. Sraml Marija dhe Sraml Lojze



FLP Hungaria, Kroacia, Bosnia-Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi, Sllovenia

Të gjithë në rrugën drejt suksesit

Nivelin e soaring managerit e arritën



Tóth Sándor dhe Vanya Edina

Nivelin e senior managerit e arritën



Császár Ibolya Tünde

Dr. Tombáczné Tanács Erika dhe

Dr. Tombácz Attila

Nivelin e managerit e arritën



Farkas Gáborné dhe Farkas Gábor

Hofbauer Rita dhe Gavalovics Gábor

Soós István dhe Soósné Zelei Mária

Glogovac Dragan

Mezei Aranka

Szöllösi Krisztina dhe Lay Csaba

Gyüre Endre dhe Gyüréné Deák Magdolna

Mitró Attila dhe Mitró Éva

Túri Lajos dhe Dobó Zsuzsanna

Nivelin e assistant managerit e arritën



Illés Kálmánné

Novaković Olga dhe Novaković Slobodan

Švabić Radmila dhe Švabić Radoslav

Kalmár Edit Krisztina

Petrović Svetlana dhe Petrović Vasilije

Tóth Sándor Tamás dhe

Kovács Zsolt dhe Kovácsné Dr. Szabó Alíz

Ruta Hajnalka dhe Szabó Richárd

Nagy Marianna

Nivelin e supervisorit e arritën



Ábrahám Katalin

Harangozó Béla

Sárközi Leila dhe Sárközi Tamás

Bánóczkiné Fehérvári Marianna

Havas András dhe Havas Andrásné

Samu István

Balázs Zsuzsanna

Herczeg Attila

Savković Tanja dhe Savković Goran

Balaton Katalin dhe Bischof Antal

Jancovicsné Pál Klára

Serlegi Lászlóné dhe Serlegi László

Barna Marika dhe Barna Duško

Kalmár Istvánné dhe Kalmár István

Sitkei Tamásné dhe Sitkei Tamás

Bathó László dhe Bathó Kinga

Kirnbauer Andrea dhe Czéh Péter

Spasov Zora dhe Spasov Rinaldo

Bodnár László dhe Varga Krisztina

Kirnbauer István

Strublik Andrea dhe Dr. Strublik Sándor

Bogdanović Gordana dhe

Kovács Ferencné dhe Kovács Ferenc

Švabić Katarina

Bogdanović Božidar

Kungl Róbert

Szabó Erzsébet Margit

Bölcskei Istvánné

Küri Attila dhe Küri Szilvia

Szenttamásiné Horváth Jolán dhe

Cenić Snežana dhe Cenić Miodrag

Lábodi Éva

Szenttamási István Tamás

Cica Sofija dhe Cica Jovan

Lovas Sándor Mihály dhe

Szolnoki Mónika

Csinádi Lili dhe Csinádi Alto

Lovas Sándor Mihályné

Szonda Tünde

Csonkáné Varga Erika

Márkus Miklósné

Terhes Mariann

Demcsák L. Miklós

Magócs Jánosné dhe Magócs János

Timár Béla

Dr. Boha Katalin

Mesaroš Vesna dhe Mesaroš Ištvan

Trencsényi Piroška

Dr. Tóth Gábor Tamás dhe

Mihailović Dragana

